

Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 11

Marrëveshjet e përbashkëta

Objektivi

- 1 Objektivi i këtij SNRF është të vendosë parimet për raportimin financiar nga njësitë ekonomike, që kanë një interes në marrëveshjet e kontrolluara bashkërisht (*dmth marrëveshjet e përbashkëta*).

Realizimi i objektivit

- 2 Për të realizuar objektivin në paragrafin 1, ky SNRF përkufizon *kontrollin e përbashkët* dhe kërkon që një njësi ekonomike, e cila është palë në një marrëveshje të përbashkët, të përcaktojë llojin e marrëveshjes së përbashkët, në të cilën është përfshirë, duke vlerësuar të drejtat dhe detyrimet e veta dhe t'i kontabilizojë këto të drejta dhe detyrime në përputhje me këtë lloj marrëveshjeje të përbashkët.

Objekti

- 3 Ky SNRF do të zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike që janë palë në një marrëveshje të përbashkët.

Marrëveshjet e përbashkëta

- 4 Një marrëveshje e përbashkët është një marrëveshje sipas të cilës dy ose më shumë palë kanë kontroll të përbashkët.
- 5 Një marrëveshje e përbashkët ka karakteristikat e mëposhtme:
 - (a) Palët janë të lidhura nga një marrëveshje kontraktuale (shih paragrafët B2–B4).
 - (b) Marrëveshja kontraktuale bën që dy apo më shumë nga këto palë të kenë kontrollin e përbashkët të marrëveshjes (shih paragrafët 7–13).
- 6 Një marrëveshje e përbashkët është, ose një *operacion i përbashkët*, ose një *sipërmarrje e përbashkët*.

Kontrolli i përbashkët

- 7 **Kontroll i përbashkët është ndarja kontraktuale, e miratuar, e kontrollit të një marrëveshjeje, kontroll ky që ekziston vetëm atëherë kur vendimet në lidhje me veprimtaritë përkatëse kërkojnë pëlqimin unanimit të palëve që ndajnë kontrollin.**
- 8 Një njësi ekonomike që është palë në një marrëveshje do të vlerësojë nëse marrëveshja kontraktuale u siguron të gjitha palëve, ose një grupi të palëve, kontrollin në mënyrë kolektive të marrëveshjes. Të gjitha palët, ose një grup i palëve, kontrollojnë kolektivisht marrëveshjen, kur ata duhet të veprojnë së bashku për të drejtuar veprimtaritë, që në mënyrë të ndjeshme ndikojnë në kthimet e marrëveshjes (p.sh. veprimtaritë përkatëse).
- 9 Pasi është vendosur që të gjitha palët, ose një grup i palëve, kontrollojë marrëveshjen kolektivisht, kontrolli i përbashkët ekziston vetëm atëherë kur vendimet në lidhje me veprimtaritë përkatëse kërkojnë pëlqimin unanimit të palëve që kontrollojnë marrëveshjen kolektivisht.
- 10 Në një marrëveshje të përbashkët, asnjë palë e vetme nuk e kontrollon marrëveshjen më vete. Një palë e marrëveshjes me kontroll të përbashkët mund të mos lejojë ndonjë nga palët e tjera, ose një grup të palëve, të ketë kontroll të marrëveshjes.
- 11 Një marrëveshje mund të jetë një marrëveshje e përbashkët edhe kur jo të gjithë palët e saj kanë kontrollin e përbashkët të marrëveshjes. Ky SNRF bën dallimin mes palëve që kanë kontrollin e përbashkët të një marrëveshjeje të përbashkët (operatorët e përbashkët apo sipërmarrësit e përbashkët) dhe palëve që marrin pjesë në të, por nuk kanë kontrollin e përbashkët të një marrëveshjeje të përbashkët.
- 12 Një njësi ekonomike duhet të përdorë gjykimin gjatë vlerësimit nëse të gjitha palët, ose një grup i palëve, kanë kontrollin e përbashkët të një marrëveshjeje. Një njësi ekonomike duhet ta bëjë këtë vlerësim duke marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat (shih paragrafët B5–B11).
- 13 Nëse faktet dhe rrethanat ndryshojnë, një njësi ekonomike do të rivlerësojë nëse ajo ende ka kontrollin e përbashkët të marrëveshjes.

Llojet e marrëveshjeve të përbashkëta

- 14 **Një njësi ekonomike do të përcaktojë llojin e marrëveshjes së përbashkët në të cilën është përfshirë. Klasifikimi i një marrëveshjeje të përbashkët, si një operacion i përbashkët ose një sipërmarrje e përbashkët, varet nga të drejtat dhe detyrimet e palëve në marrëveshje.**

- 15 **Një operacion i përbashkët është një marrëveshje e përbashkët ku palët, që kanë kontrollin e përbashkët të marrëveshjes, kanë të drejta mbi aktivet dhe detyrime për pasivet, në lidhje me marrëveshjen. Këto palë quhen operatorë të përbashkët.**
- 16 **Një sipërmarrje e përbashkët është një marrëveshje e përbashkët ku palët, që kanë kontrollin e përbashkët të marrëveshjes, kanë të drejta mbi aktivet neto të marrëveshjes. Këto palë quhen sipërmarrës të përbashkët.**
- 17 Një njësi ekonomike përdor gjykimin gjatë vlerësimit nëse një marrëveshje e përbashkët është një operacion i përbashkët apo një sipërmarrje e përbashkët. Një njësi ekonomike do të përcaktojë llojin e marrëveshjes së përbashkët, në të cilën është përfshirë, duke marrë në konsideratë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja. Një njësi ekonomike vlerëson të drejtat dhe detyrimet e saj duke marrë parasysh strukturën dhe formën ligjore të marrëveshjes, termat për të cilat është rënë dakord nga palët në marrëveshjen kontraktuale dhe, kur është e nevojshme, faktet dhe rrethanat e tjera (shih paragrafët B12–B33).
- 18 Ndonjëherë palët janë të lidhura nga një kuadër marrëveshjeje që përcakton kushtet e përgjithshme të kontratës për ndërmarrjen e një ose më shumë veprimtarive. Kuadri mund të caktojë që palët lidhin marrëveshjeve të ndryshme të përbashkëta për t'u marrë me veprimtari të veçanta që janë pjesë e marrëveshjes. Edhe pse këto marrëveshje të përbashkëta janë të lidhura me të njëjtin kuadër, ato mund të jenë të llojeve të ndryshme, nëse të drejtat dhe detyrimet e palëve ndryshojnë, kur ndërmerren veprimtaritë e ndryshme të trajtuara në kuadrin e marrëveshjes. Rrjedhimisht, operacionet e përbashkëta dhe sipërmarrjet e përbashkëta mund të bashkekzistojnë kur palët ndërmarrin veprimtari të ndryshme që janë pjesë e të njëjtit kuadër marrëveshjeje.
- 19 Po qe se faktet dhe rrethanat ndryshojnë, një njësi ekonomike do të rivlerësojë nëse lloji i marrëveshjes së përbashkët, në të cilën është e përfshirë, ka ndryshuar.

Pasqyrat financiare të palëve në një marrëveshje të përbashkët

Operacionet e përbashkëta

- 20 **Një operator i përbashkët, në lidhje me interesin e tij në një operacion të përbashkët, do të njohë:**

- (a) **aktivet e tij, duke përfshirë pjesën e tij mbi çdo aktiv të zotëruar së bashku;**
 - (b) **pasivet e tij, duke përfshirë pjesën e tij të çdo detyrim i shkaktuar së bashku;**
 - (c) **të ardhurat e tij nga shitja e pjesës së tij të produktit që del nga operacioni i përbashkët;**
 - (d) **pjesën e tij të të ardhurave nga shitja e produktit të operacionit të përbashkët; dhe**
 - (e) **shpenzimet e tij, duke përfshirë pjesën e tij në çdo shpenzim të bërë së bashku.**
- 21 Një operator i përbashkët do të kontabilizojë aktivet, pasivet, të ardhurat dhe shpenzimet, që lidhen me interesin e tij në një operacion të përbashkët, në përputhje me SNRF-të që zbatohen për aktive, pasive, të ardhura dhe shpenzime të veçanta.
- 22 Kontabiliteti për transaksione të tilla si shitje, kontribut apo blerje e aktiveve midis një njësie ekonomike dhe një operacioni të përbashkët, në të cilën ajo është një operator i përbashkët, është specifikuar në paragrafët B34–B37.
- 23 Një palë që merr pjesë në një operacion të përbashkët, por nuk ka kontroll të përbashkët në të, do të kontabilizojë gjithashtu interesat e saj në marrëveshje në përputhje me paragrafët 20-22, në qoftë se pala ka të drejta mbi aktivet dhe detyrime për pasivet, në lidhje me operacionin e përbashkët. Nëse një palë që merr pjesë në një operacion të përbashkët, por nuk ka kontroll të përbashkët, nuk ka të drejta mbi aktivet dhe detyrime për pasivet, në lidhje me këtë operacion të përbashkët, ajo do ta trajtojë interesin e saj në operacionin e përbashkët në përputhje me SNRF- të që zbatohen për këtë interes.

Sipërmarrjet e përbashkëta

- 24 **Një sipërmarrës i përbashkët do ta njohë interesin e tij në një sipërmarrje të përbashkët, si një investim dhe do ta kontabilizojë këtë investim duke përdorur metodën e kapitalit neto në përputhje me SNK 28 *Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta*, nëse njësi ekonomike nuk përjashtohet nga zbatimi i metodës së kapitalit neto, siç specifikohet në këtë standard.**
- 25 Një palë që merr pjesë në një sipërmarrje të përbashkët, por nuk ka kontroll të përbashkët, do ta kontabilizojë interesin e saj në marrëveshje në përputhje me SNRF 9 *Instrumentet financiare*, nëse ajo nuk ka influencë të konsiderueshme mbi sipërmarrjen e përbashkët, rast në të cilin ajo do ta kontabilizonte në përputhje me SNK 28 (i ndryshuar në 2011).

Pasqyrat financiare individuale

- 26** Në pasqyrat e tij financiare individuale, një operator i përbashkët apo sipërmarrës i përbashkët do ta kontabilizojnë interesin e tij në:
- (a) një operacion të përbashkët në përputhje me paragrafët 20–22;
 - (b) në një sipërmarrje të përbashkët në përputhje me paragrafin 10 të *SNK 27 Pasqyrat financiare individuale*.
- 27** Në pasqyrat e saj financiare individuale, një palë që merr pjesë në një marrëveshje të përbashkët, por nuk ka kontroll të përbashkët në të, do ta kontabilizojë interesin e saj në:
- (a) një operacion të përbashkët në përputhje me paragrafin 23;
 - (b) në një sipërmarrje të përbashkët në përputhje me SNRF 9, nëse njësia ekonomike nuk ka influencë të konsiderueshme mbi sipërmarrjen, rast në të cilin ajo do të zbatojë paragrafin 10 të *SNK 27* (i ndryshuar në vitin 2011).

Shtojca A

Termet e përkufizuar

Kjo shtojcë është pjesë integrale e SNRF-së.

marrëveshje e përbashkët	Një marrëveshje nga e cila dy ose më shumë palë kanë kontroll të përbashkët .
kontrolli i përbashkët	Ndarja kontraktuale e miratuar e kontrollit të një marrëveshjeje, kontroll ky që ekziston vetëm atëherë, kur vendimet në lidhje me veprimtaritë përkatëse kërkojnë pëlqimin unanimit të palëve që ndajnë kontrollin.
operacion i përbashkët	Një marrëveshje e përbashkët ku palët, që kanë kontrollin e përbashkët të marrëveshjes, kanë të drejta në aktivet dhe detyrime në pasivet, në lidhje me marrëveshjen.
operator i përbashkët	Një palë në një operacion të përbashkët që ka kontroll të përbashkët të këtij operacion të përbashkët.
sipërmarrje e përbashkët	Një marrëveshje e përbashkët ku palët që kanë kontrollin e përbashkët të marrëveshjes kanë të drejta në aktivet neto të marrëveshjes.
sipërmarrës i përbashkët	Një palë në një sipërmarrje të përbashkët që ka kontrollin e përbashkët të kësaj sipërmarrje të përbashkët.
palë në një marrëveshje të përbashkët	Një njësi ekonomike që merr pjesë në një marrëveshje të përbashkët , pa marrë parasysh nëse njësi ekonomike ka kontrollin e përbashkët të marrëveshjes.
mjet financiar i veçantë	Një strukturë financiare e identifikueshme veçmas, përfshirë njësi ekonomike të veçanta ligjore ose njësi ekonomike të njohura me statut, pavarësisht nga fakti nëse këto njësi ekonomike kanë një personalitet ligjor.

Përkufizimet e termave të mëposhtëm jepen në SNK 27(i ndryshuar në 2011), SNK 28 (i ndryshuar në 2011) ose SNRF10 *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara* dhe janë përdorur në këtë standard sipas kuptimit të dhënë në SNRF-të ku ato janë përcaktuar:

- kontrolli i një të investuari
- metoda e kapitalit neto
- fuqia
- të drejtat mbrojtëse
- veprimtaritë përkatëse
- pasqyra financiare individuale
- influencë e konsiderueshme.

Shtojca B

Udhëzim për zbatim

Kjo shtojcë është pjesë integrale e SNRF-së. Ajo përshkruan zbatimin e paragrafëve 1-27 dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të SNRF-së.

- B1 Shembujt në këtë shtojcë karakterizojnë situata hipotetike. Edhe pse disa aspekte të shembujve mund të jenë të pranishme në modelet faktike, kur të zbatohet SNRF 11 do të duhej të vlerësoheshin të gjitha faktet përkatëse dhe rrethanat e një modeli të veçantë faktik.

Marrëveshjet e përbashkëta

Marrëveshja kontraktuale (paragrafi 5)

- B2 Marrëveshjet kontraktuale mund të evidentohen në disa mënyra. Një marrëveshje kontraktuale, e zbatueshme me forcë, është shpesh, por jo gjithmonë, me shkrim, zakonisht në formën e një kontrate ose diskutimi të dokumentuar mes palëve. Mekanizmat statutorë gjithashtu mund të krijojnë marrëveshje të zbatueshme me forcë, qoftë vetë ose në lidhje me kontratat ndërmjet palëve.
- B3 Kur marrëveshjet e përbashkëta janë të strukturuar përmes një *mjeti financiar të veçantë* (shih paragrafët B19 të B33), marrëveshja kontraktuale, ose disa aspekte të marrëveshjes kontraktuale, në disa raste, do të përfshihen në nenet, statutin ose aktet nënligjore të mjetit të veçantë.
- B4 Marrëveshja kontraktuale përcakton kushtet mbi të cilat palët marrin pjesë në veprimtarinë që është subjekt i marrëveshjes. Marrëveshja kontraktuale në përgjithësi merret me çështje të tilla si:
- (a) qëllimi, veprimtaria dhe kohëzgjatja e marrëveshjes së përbashkët.
 - (b) mënyra se si janë emëruar anëtarët e bordit të drejtorëve ose organit ekuivalent qeverisës të marrëveshjes së përbashkët.
 - (c) procesi i vendimmarrjes: çështjet që kërkojnë vendime nga palët, të drejtat e votës të palëve dhe nivelin e kërkuar të mbështetjes për këto çështje. Procesi i vendimmarrjes, i pasqyruar në marrëveshje kontraktuale, krijon kontrollin e përbashkët të marrëveshjes (shih paragrafët B5–B11).
 - (d) kapitali ose kontributet e tjera që kërkohen prej palëve.
 - (e) palët ndajnë aktivet, detyrimet, të ardhurat, shpenzimet ose fitimin apo humbjen në lidhje me marrëveshjen e përbashkët.

Kontrolli i përbashkët (paragrafët 7–13)

- B5** Në vlerësimin nëse një njësi ekonomike ka kontroll të përbashkët në një marrëveshje, një njësi ekonomike duhet të vlerësojë së pari, nëse të gjitha palët, ose një grup i palëve kontrollojnë marrëveshjen. Përkufizimi i kontrollit jepet në SNRF 10 dhe do të përdoret për të përcaktuar nëse të gjitha palët, ose një grup i palëve janë të ekspozuar, apo kanë të drejta, ndaj kthimeve të ndryshueshme nga përfshirja e tyre në marrëveshje dhe kanë aftësinë të ndikojnë në këto kthime me anë të pushtetit të tyre mbi marrëveshjen. Kur të gjitha palët, ose një grup i palëve, të marra bashkarisht, janë në gjendje të drejtojnë veprimtaritë që ndikojnë ndjeshëm në kthimet e marrëveshjes (dmth. veprimtaritë përkatëse), palët kontrollojnë kolektivisht marrëveshjen.
- B6** Pas përfundimit se të gjitha palët, ose një grup i palëve, kontrollojnë kolektivisht marrëveshjen, një njësi ekonomike duhet të vlerësojë nëse ajo ka kontroll të përbashkët të marrëveshjes. Kontrolli i përbashkët ekziston vetëm kur vendimet në lidhje me veprimtaritë përkatëse kërkojnë pëlqimin unanimit të palëve që kolektivisht kontrollojnë marrëveshjen. Vlerësimi nëse marrëveshja është e kontrolluar bashkërisht nga të gjitha palët e saj ose nga një grup i palëve, ose kontrollohet vetëm nga një prej palëve të saj, mund të kërkojë gjykim.
- B7** Ndonjëherë procesi i vendimmarrjes që është pranuar nga palët në marrëveshjen kontraktuale të tyre, në mënyrë të nënkuptuar, çon në kontroll të përbashkët. Për shembull, supozojmë se dy palë lidhin një marrëveshje në të cilën secila ka 50 përqind të të drejtave të votës dhe marrëveshja kontraktuale ndërmjet tyre përcakton se janë të nevojshme të paktën 51 përqind e të drejtave të votës për të marrë vendime në lidhje me veprimtaritë përkatëse. Në këtë rast, palët kanë rënë dakord në mënyrë të nënkuptuar se ata kanë kontrollin e përbashkët të marrëveshjes, për shkak se vendimet në lidhje me veprimtaritë përkatëse nuk mund të bëhen pa miratimin e të dyja palëve.
- B8** Në rrethana të tjera, marrëveshja kontraktuale kërkon një minimum të të drejtave të votës për të marrë vendime në lidhje me veprimtaritë përkatëse. Kur ky minimum i kërkuar të drejtat e votës mund të arrihet me më shumë se një kombinim i palëve të rëna dakord së bashku, kjo marrëveshje nuk është një marrëveshje e përbashkët, përveç nëse marrëveshja kontraktuale specifikon se cilat palë (apo kombinim i palëve), kërkohej të bien dakord njëzëri për vendimet mbi veprimtaritë përkatëse të marrëveshjes.

Shembuj zbatimi

Shembull 1

Supozojmë se tre palët vendosin një marrëveshje: A ka 50 për qind të të drejtave të votës në marrëveshje, B ka 30 për qind dhe C ka 20 për qind. Marrëveshja kontraktuale mes A, B dhe C specifikon se është e nevojshme të paktën 75 për qind e të drejtave të votës për të marrë vendime në lidhje me veprimtaritë përkatëse të marrëveshjes. Edhe pse A mund të bllokojë çdo vendim, ajo nuk kontrollon marrëveshjen, sepse ka nevojë për marrëveshjen e B-së. Kushtet e marrëveshjes së tyre kontraktuale, që kërkon të paktën 75 për qind e të drejtave të votës për të marrë vendime në lidhje me veprimtaritë përkatëse, nënkupton që A dhe B kanë kontroll të përbashkët të marrëveshjes, sepse vendimet në lidhje me veprimtaritë përkatëse të saj nuk mund të bëhet pa rënë dakord të dy A dhe B.

Shembull 2


Supozojmë se një marrëveshje ka tre palë: A ka 50 për qind të të drejtave të votës në marrëveshje dhe B dhe C kanë secila 25 për qind. Marrëveshja kontraktuale mes A, B dhe C specifikon se është e nevojshme të paktën 75 për qind e të drejtave të votës për të marrë vendime në lidhje me veprimtaritë përkatëse të marrëveshjes. Edhe pse A mund të bllokojë çdo vendim, ajo nuk kontrollon marrëveshjen, sepse ajo ka nevojë për marrëveshjen ose të B-së, ose C-së. Në këtë shembull, A, B dhe C kontrollojnë kolektivisht marrëveshjen. Megjithatë, ka më shumë se një kombinim të palëve që mund të bien dakord për të arritur 75 për qindësin e të drejtave të votës (dmth ose A dhe B, ose A dhe C). Në një situatë të tillë, që të jetë një marrëveshje e përbashkët, marrëveshja kontraktuale ndërmjet palëve do të duhet të përcaktojë se cili kombinim i palëve është i nevojshme që të bien dakord njëzëri për vendimet në lidhje me veprimtaritë përkatëse të marrëveshjes.

Shembull 3

Supozojmë një marrëveshje në të cilën A dhe B, secila ka 35 për qind të të drejtave të votës në marrëveshje, ndërsa pjesa e mbetur 30 për qind është shpërndarë gjerësisht. Vendimet në lidhje me veprimtaritë përkatëse kërkojnë miratimin nga një shumicë e të drejtave të votës. A dhe B kanë kontrollin e përbashkët të marrëveshjes vetëm nëse marrëveshja kontraktuale specifikon se vendimet në lidhje me veprimtaritë përkatëse të marrëveshjes kërkojnë të bien dakord të dy palët A dhe B.

- B9 Kërkesa për miratimin unanim do të thotë që çdo palë me kontroll të përbashkët të marrëveshjes mund të ndalojë ndonjë nga palët e tjera, ose një grup të palëve, të marrin vendime të njëanshme (në lidhje me veprimtaritë përkatëse) pa pëlqimin e saj. Nëse kërkesa për miratimin unanim ka të bëjë vetëm me vendimet që i japin një palë të drejta mbrojtëse dhe jo me vendimet rreth veprimtarive përkatëse të një marrëveshjeje, atëherë kjo palë nuk është një palë e marrëveshjes me kontroll të përbashkët.
- B10 Një marrëveshje kontraktuale mund të përfshijë klauzola për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të tilla si arbitrazhi. Këto dispozita mund të lejojnë që të merren vendime në mungesë të pëlqimit unanim midis palëve që kanë kontrollin e përbashkët. Ekzistenca e këtyre dispozitave nuk e pengon marrëveshjen që të kontrollohet në mënyrë të përbashkët dhe, rrjedhimisht, të jetë një marrëveshje e përbashkët.

Vlerësimi i kontrollit të përbashkët



B11 Kur një marrëveshje është jashtë objektit të SNRF 11, një njësi ekonomike kontabilizon interesin e saj në marrëveshje në përputhje me SNRF-të përkatëse, të tilla si SNRF 10, SNK 28 (i ndryshuar në 2011) ose SNRF 9.

Llojet e marrëveshjeve të përbashkëta (paragrafët 14–19)

- B12 Marrëveshjet e përbashkëta lidhen për qëllime të ndryshme (p.sh. si një mënyrë që palët të ndajnë kostot dhe rreziqet, apo si një mënyrë që palët të sigurojnë qasje në teknologjinë e re apo në tregjet e reja), dhe mund të lidhen duke përdorur struktura dhe forma ligjore të ndryshme.
- B13 Disa marrëveshje nuk kërkojnë që veprimtaria, e cila është subjekt i marrëveshjes, të ndërmerret me anë të një mjeti financiar të veçantë. Megjithatë, marrëveshje të tjera përfshijnë krijimin e një mjeti financiar të veçantë.
- B14 Klasifikimi i marrëveshjeve të përbashkëta, siç kërkohet nga ky SNRF, varet nga të drejtat e palëve dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja në rrjedhën normale të biznesit. Ky SNRF klasifikon marrëveshjet e përbashkëta ose si operacione të përbashkëta, ose sipërmarrje të përbashkëta. Kur njësi ekonomike ka të drejta mbi aktivet dhe detyrime për pasivet, në lidhje me marrëveshjen, atëherë marrëveshja është një operacion i përbashkët. Kur njësi ekonomike ka të drejta mbi aktivet neto të marrëveshjes, marrëveshja është një sipërmarrje e përbashkët. Paragrafët B16-B33 përcaktojnë vlerësimin që bën një njësi ekonomike për të përcaktuar nëse ajo ka një interes në një operacion të përbashkët, ose një interes në një sipërmarrje të përbashkët.

Klasifikimi i një marrëveshje të përbashkët

- B15 Siç thuhet në paragrafin B14, klasifikimi i marrëveshjeve të përbashkëta kërkon që palët të vlerësojnë të drejtat e tyre dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja. Kur bën këtë vlerësim, njësi ekonomike do të marrë parasysh si më poshtë:
- (a) strukturën e marrëveshjes së përbashkët (shih paragrafët B16–B21).
 - (b) kur marrëveshja e përbashkët është e strukturuar përmes një mjeti të veçantë:
 - (i) formën ligjore të mjetit të veçantë (shih paragrafët B22–B24);
 - (ii) kushtet e marrëveshjes kontraktuale (shih paragrafët B25–B28); dhe
 - (iii) kur është e nevojshme, faktet dhe rrethanat e tjera (shih paragrafët B29–B33).

Struktura e marrëveshjes së përbashkët

Marrëveshjet e përbashkëta që nuk janë të strukturuar përmes një mjeti të veçantë


- B16 Një marrëveshje e përbashkët, që nuk është e strukturuar përmes një mjeti të veçantë, është një operacion i përbashkët. Në raste të tilla, marrëveshja kontraktuale vendos të drejtat e palëve për aktivet dhe detyrimet për pasivet, në lidhje me marrëveshjen, dhe të drejtat e palëve për të ardhurat përkatëse dhe detyrimet për shpenzimet përkatëse.
- B17 Marrëveshja kontraktuale shpesh përshkruan natyrën e veprimtarive që janë subjekt i marrëveshjes dhe mënyrën se si palët synojnë të ndërmarrin këto veprimtari së bashku. Për shembull, palët në një marrëveshje të përbashkët mund të bien dakord për prodhimin e një produkti së bashku, ku secila palë është përgjegjëse për një detyrë të caktuar dhe secila përdor aktivet e veta dhe merr përsipër detyrimet e veta. Marrëveshja kontraktuale mund të specifikojë gjithashtu se si duhet të ndahen midis palëve të ardhurat dhe shpenzimet që janë të përbashkëta për to. Në një rast të tillë, çdo operator i përbashkët njihet në pasqyrat e tij financiare aktivet dhe pasivet e përdorura për detyrën e veçantë, dhe njihet pjesën e tij të të ardhurave dhe shpenzimeve në përputhje me marrëveshjen kontraktuale.
- B18 Në raste të tjera, palët në një marrëveshje të përbashkët mund të bien dakord, për shembull, të ndajnë dhe të shfrytëzojnë një aktiv së bashku. Në një rast të tillë, marrëveshja kontraktuale vendos të drejtat e palëve për aktivin që shfrytëzohet bashkërisht, dhe se si ndahen midis palëve produkti ose të ardhurat nga aktivin dhe kostot e shfrytëzimit. Secili nga operatorët e përbashkët kontabilizojnë pjesën e tij të aktivit të përbashkët dhe pjesën e tij të rënë dakord të detyrimeve, dhe njihet pjesën e tij të produktit, të të ardhurave, dhe shpenzimeve në përputhje me marrëveshjen kontraktuale.

Marrëveshjet e përbashkëta të strukturuar përmes një mjeti të veçantë

- B19 Një marrëveshje e përbashkët, në të cilën aktivet dhe pasivet në lidhje me të mbahen me anën e një mjeti të veçantë, mund të jetë një sipërmarrje e përbashkët ose një operacion i përbashkët.
- B20 Nëse një palë është një operator i përbashkët ose një sipërmarrës i përbashkët varet nga të drejtat e palës në aktivet dhe detyrimet për pasivet, në lidhje me marrëveshjen, që zotërohen në mjetin e veçantë.
- B21 Siç thuhet në paragrafin B15, kur palët kanë strukturuar një marrëveshje të përbashkët në një mjet të veçantë, palët duhet të vlerësojnë nëse forma ligjore e mjetit të veçantë, kushtet e marrëveshjes kontraktuale dhe, kur është e nevojshme, faktet dhe rrethanat e tjera u japin atyre:

- (a) të drejta ndaj aktiveve dhe detyrime ndaj pasiveve, në lidhje me marrëveshjen (dmth marrëveshja është një operacion i përbashkët); ose
- (b) të drejta ndaj aktiveve neto të marrëveshjes (dmth marrëveshja është një sipërmarrje e përbashkët).

Klasifikimi i një marrëveshje të përbashkët: vlerësimi i të drejtave të palëve dhe i detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja



Forma ligjore e mjetit të veçantë

- B22** Forma ligjore e mjetit të veçantë është e rëndësishme gjatë vlerësimit të llojit të marrëveshjes së përbashkët. Forma ligjore ndihmon në vlerësimin fillestar të të drejtave të palëve mbi aktivet dhe detyrimeve mbi pasivet e zotëruara në mjetin e veçantë, të tilla si nëse palët kanë interesa në aktivet e zotëruara në mjetin e veçantë dhe nëse janë përgjegjëse ndaj pasiveve të zotëruara në mjetin e veçantë.
- B23** Për shembull, palët mund të realizojnë marrëveshjen e përbashkët përmes një mjeti të veçantë, forma ligjore e të cilit bën që ai të konsiderohet në të drejtën e vet (dmth. aktivet dhe detyrimet që ka mjeti i veçantë janë aktivet dhe detyrimet e tij dhe jo të palëve). Në një rast të tillë, vlerësimi i të drejtave dhe detyrimeve që u akordohen palëve sipas formës juridike të mjetit të veçantë tregon se marrëveshja është një sipërmarrje e përbashkët. Megjithatë, kushtet e pranuar nga palët në marrëveshjen e tyre kontraktuale (shih paragrafët B25-B28) dhe, kur është e nevojshme, faktet dhe rrethanat e tjera (shih paragrafët B29 të B33) mund të jenë në kundërshtim me vlerësimin e të drejtave dhe detyrimeve që u akordohen palëve sipas formës ligjore të mjetit të veçantë.
- B24** Vlerësimi i të drejtave dhe detyrimeve, të akorduara palëve sipas formës ligjore të mjetit të veçantë, është i mjaftueshëm për të konkluduar se marrëveshja është një operacion i përbashkët vetëm nëse palët realizojnë marrëveshjen e përbashkët në një mjet të veçantë, forma ligjore e të cilit nuk e vë në diskutim ndarjen midis palëve dhe mjetit të veçantë (dmth. aktivet dhe detyrimet që janë në mjetin e veçantë janë aktive dhe detyrime të palëve).

Vlerësimi i kushteve të marrëveshjes kontraktuale

- B25** Në shumë raste, të drejtat dhe detyrimet e pranuar nga palët në marrëveshjet e tyre kontraktuale janë në përputhje, ose nuk janë në konflikt, me të drejtat dhe detyrimet që u akordohen palëve sipas formës ligjore të mjetit të veçantë në të cilin është strukturuar marrëveshja.
- B26** Në raste të tjera, palët përdorin marrëveshjen kontraktuale për të ndryshuar apo modifikuar të drejtat dhe detyrimet e akorduara nga forma juridike e mjetit të veçantë në të cilin është strukturuar marrëveshja.

Shembuj zbatimi
Shembull 4

Supozojmë se dy palë strukturojnë një marrëveshje të përbashkët në një njësi ekonomike të **inkorporuar**. Secila palë ka 50 për qind interes të pronësisë në njësinë ekonomike të inkorporuar. Inkorporimi mundëson veçimin e njësisë ekonomike nga pronarët e saj dhe si rrjedhim aktivet dhe detyrimet që ka njësia ekonomike janë aktive dhe detyrime të njësisë ekonomike të inkorporuar. Në një rast të tillë, vlerësimi i të drejtave dhe i detyrimeve që u akordohen palëve nga forma ligjore e mjetit të veçantë tregon se palët kanë të drejta mbi aktivet neto të marrëveshjes.

Megjithatë, palët modifikojë karakteristikat e korporatës përmes marrëveshjes së tyre kontraktuale në mënyrë që secila ka një interes në aktivet e njësisë ekonomike të inkorporuar dhe secila është përgjegjëse për detyrimet e njësisë ekonomike të inkorporuar në një përpjesëtim të caktuar. Modifikime të tilla kontraktuale në karakteristikat e një korporate mund të bëjë që një marrëveshje të jetë një operacion i përbashkët.

- B27 Tabela e mëposhtme krahason kushtet e përbashkëta në marrëveshjet kontraktuale të palëve për një operacion të përbashkët dhe kushtet e përbashkëta në marrëveshjet kontraktuale të palëve në një sipërmarrje të përbashkët. Shembujt e kushteve kontraktuale të dhëna në tabelën e mëposhtme nuk janë shteruese.

Vlerësimi i kushteve të marrëveshjes kontraktuale		
	Operacion i përbashkët	Sipërmarrje e përbashkët
Kushtet e marrëveshjes kontraktuale	Marrëveshja kontraktuale u jep palëve në marrëveshjen e përbashkët, të drejta mbi aktivet dhe detyrime ndaj pasiveve, në lidhje me marrëveshjen.	Marrëveshja kontraktuale u jep palëve, në marrëveshjen e përbashkët, të drejta mbi aktivet neto të marrëveshjes (dmth është mjete i veçantë, dhe jo palët, që ka të drejta mbi aktivet dhe detyrime ndaj pasiveve, në lidhje me marrëveshjen).
Të drejtat mbi aktivet	Marrëveshja kontraktuale përcakton se palët në marrëveshjen e përbashkët ndajnë të gjitha interesat (p.sh. të drejtat, titullin e pronësisë) mbi aktivet, në lidhje me marrëveshjen, në një përpjestim të caktuar (p.sh. në përpjesëtim me interesin e pronësisë së palëve në marrëveshje ose në përpjesëtim me veprimtarinë që realizohet nëpërmjet marrëveshjes, që u ngarkohet drejtpërdrejt atyre).	Marrëveshja kontraktuale përcakton që aktivet e kontribuara në marrëveshje apo të blera më pas sipas marrëveshjes së përbashkët janë aktive të marrëveshjes. Palët nuk kanë interesa (dmth nuk kanë të drejta, titull ose pronësi) në aktivet e marrëveshjes.

Detyrimet për pasivet	Marrëveshja kontraktuale përcakton se palët në marrëveshjen e përbashkët ndajnë të gjitha pasivet, detyrimet, kostot dhe shpenzimet në një përpjesëtim të caktuar (p.sh. në përpjesëtim me interesin e pronësisë të palëve në marrëveshje ose në përpjesëtim me aktivitetin e kryer gjatë marrëveshjes që u ngarkohen drejtpërdrejt atyre).	Marrëveshja kontraktuale vendos që marrëveshja e përbashkët është përgjegjëse për borxhet dhe detyrimet e marrëveshjes.
		Marrëveshja kontraktuale vendos që palët në marrëveshjen e përbashkët janë të detyruar ndaj marrëveshjes vetëm në masën përkatëse të investimeve të tyre në marrëveshje ose për detyrimet përkatëse të tyre për të kontribuar në marrëveshje duke shlyer kapitalin e papaguar ose me kapital shtesë, ose të dyja njëkohësisht .
	Marrëveshja kontraktuale vendos që palët në marrëveshjen e përbashkët janë përgjegjës për pretendimet e ngritura nga palët e treta.	Marrëveshjet kontraktuale shpallin se kreditorët e marrëveshjes së përbashkët nuk kanë të drejta të rekursit kundrejt çdo pale në lidhje me borxhet ose detyrimet e marrëveshjes.

<p>Të ardhurat, shpenzimet, fitimi ose humbja KETU !!!!!</p>	<p>Marrëveshja kontraktuale përcakton shpërndarjen e të ardhurave dhe shpenzimeve në bazë të performancës relative të secilës palë në marrëveshjen e përbashkët. Për shembull, marrëveshja kontraktuale mund të caktojë që të ardhurat dhe shpenzimet të shpërndahen në bazë të kapacitetit që secila palë përdor në një fabrikë të shfrytëzuar bashkërisht, që mund të ndryshojë nga interesat e tyre të pronësisë në marrëveshjen e përbashkët. Në raste të tjera, palët mund të bien dakord për të ndarë fitimin ose humbjen në lidhje me marrëveshjen në bazë të një proporcioni të specifikuar të tillë si interesi i pronësisë i palëve në marrëveshje. Kjo nuk e pengon marrëveshjen të jetë një operacion i përbashkët, në qoftë se palët kanë të drejta mbi aktivet dhe detyrime për pasivet, në lidhje me marrëveshjen.</p>	<p>Marrëveshja kontraktuale përcakton pjesën e secilës palë në fitim ose humbje në lidhje me veprimtaritë e marrëveshjes.</p>
--	---	---

Garancitë	Palët në marrëveshje të përbashkëta kërkohet shpesh që t'u ofrojnë garanci palëve të treta, për shembull, që të sigurojnë një shërbim nga marrëveshja e përbashkët apo financime. Dhënia e garancive të tilla, apo angazhimi nga ana e palëve për t'i siguruar ato, nuk do të thotë aspak, se vetvetiu përcaktojnë se marrëveshja e përbashkët është një operacion i përbashkët. Karakteristika që përcakton nëse marrëveshja e përbashkët është një operacion i përbashkët ose një sipërmarrje e përbashkët është nëse palët kanë detyrime për pasivet, në lidhje me marrëveshjen (për disa nga të cilat palët mund ose nuk mund të kenë dhënë një garanci).
------------------	---

B28 Kur marrëveshja kontraktuale specifikon se palët kanë të drejta mbi aktivet dhe detyrime për pasivet, në lidhje me marrëveshjen, ata janë palë në një operacion të përbashkët dhe nuk kanë nevojë të marrin në konsideratë faktet dhe rrethanat e tjera (paragrafët B29-B33) për qëllime të klasifikimit të marrëveshjes së përbashkët.

Vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të tjera

B29 Kur kushtet e marrëveshjes kontraktuale nuk e specifikojnë se palët kanë të drejtë për aktivet dhe detyrime për pasivet, në lidhje me marrëveshjen, palët do të marrin parasysh faktet dhe rrethanat e tjera për të vlerësuar nëse marrëveshja është një operacion i përbashkët apo një sipërmarrje e përbashkët.

B30 Një marrëveshje e përbashkët mund të strukturohet në një mjet të veçantë, forma ligjore e të cilit **bën** ndarjen mes palëve dhe mjetit të veçantë. Kushtet kontraktuale të pranuar midis palëve nuk mund të specifikojnë të drejtat e palëve për aktivet dhe detyrimet për pasivet, por shqyrtimi i fakteve dhe rrethanave të tjera mund të çojë që një marrëveshje e tillë të klasifikohet si një operacion i përbashkët. Ky është rasti kur faktet dhe rrethanat e tjera u japin palëve të drejta mbi aktivet dhe krijojnë detyrime për pasivet, në lidhje me marrëveshjen.

B31 Kur veprimtaritë e një marrëveshje janë konceptuar kryesisht për sigurimin e prodhimit për palët, kjo tregon se palët kanë të drejta, në thelb, në të gjitha përfitimet ekonomike të aktiveve të marrëveshjes. Palët, në marrëveshje të tilla, shpesh sigurojnë aksesin e tyre ndaj produkteve të siguruar nga marrëveshja, duke mos e lejuar marrëveshjen ta shesë produktin tek palët e treta.

B32 Efekti i një marrëveshjeje, me një konceptim dhe qëllim të tillë, është që detyrimet e krijuara nga marrëveshja janë, në thelb, shlyhen nga flukset monetare të arkëtuara nga palët nëpërmjet blerjeve të produktit nga ana e tyre. Kur palët janë, në thelb, burimi i vetëm i flukseve të mjeteve monetare

duke kontribuar në vazhdimësinë e operacioneve të marrëveshjes, kjo tregon se palët kanë një detyrim për pasivet në lidhje me marrëveshjen.

Shembull zbatimi

Shembull 5

Supozojmë se dy palë strukturojnë një marrëveshje të përbashkët në një njësi ekonomike të inkuorporuar (njësia ekonomike C), në të cilën secila palë zotëron 50 për qind të interesit të pronësisë. Qëllimi i marrëveshjes është të prodhojë materiale që kërkohen nga palët për proceset e tyre individuale të prodhimit. Marrëveshja siguron që palët të shfrytëzojnë lehtësirat që prodhojnë materiale sipas specifikimeve të tyre për sasinë dhe cilësinë.

Forma ligjore e njësisë ekonomike C (një njësi ekonomike e inkuorporuar), nëpërmjet të cilës janë kryer fillimisht veprimtaritë, tregon se aktivet dhe pasivet që ka njësia ekonomike C janë aktive dhe pasive të njësisë ekonomike C. Marrëveshja kontraktuale ndërmjet palëve nuk specifikon se palët kanë drejta për aktivet ose detyrime për pasivet e njësisë ekonomike C. Kështu, forma ligjore e njësisë ekonomike C dhe kushtet e marrëveshjes kontraktuale tregojnë se marrëveshja është një sipërmarrje e përbashkët.

Megjithatë, palët marrin parasysh gjithashtu aspektet e mëposhtme të marrëveshjes:

- Palët kanë rënë dakord për të blerë gjithë produktin e prodhuar nga njësia ekonomike C në një raport prej 50:50. Njësia ekonomike C nuk mund t'u shesë palëve të treta ndonjë nga produktet e saj, përveç rastit kur një gjë e tillë është miratuar nga të dy palët në marrëveshje. Për shkak se qëllimi i marrëveshjes është t'u ofrojë palëve produktin që ata kërkojnë, këto shitje tek palët e treta pritet të jenë jo të zakonshme dhe as materiale.
- Çmimi i produktit të shitur tek palët vendoset nga ato në një nivel që është përcaktuar për të mbuluar shpenzimet e prodhimit dhe ato administrative të kryera nga njësia ekonomike C. Mbi bazën e këtij modeli shfrytëzimi, marrëveshja ka për qëllim të veprojë në nivelin e pikës së ekuilibrit.

Nga modeli i mësipërm faktik, faktet dhe rrethanat e mëposhtme janë të rëndësishme:

- Detyrimi i palëve për të blerë gjithë produktin e prodhuar nga njësia ekonomike C pasqyron varësinë ekskluzive të njësisë ekonomike C nga palët për gjenerimin e flukseve të mjeteve monetare dhe, kështu, palët kanë një detyrim të financojnë shlyerjen e pasiveve të njësisë ekonomike C.
- Fakti që palët kanë të drejta në të gjithë produktin e prodhuar nga njësia ekonomike C do të thotë se palët konsumojnë, dhe për këtë arsye kanë të drejta në të gjitha përfitimet ekonomike të aktiveve të njësisë ekonomike C.


Këto fakte dhe rrethana tregojnë se marrëveshja është një operacion i përbashkët. Përfundimi në lidhje me klasifikimin e marrëveshjes së përbashkët, në këto rrethana, nuk do të ndryshojë edhe nëse palët ua shesin pjesën e tyre të produktit palëve të treta, në vend që ta përdorin në procesin e mëparshëm të prodhimit të tyre.

Nëse palët ndryshojnë kushtet e marrëveshjes kontraktuale në mënyrë që marrëveshja të ketë mundësi të shesë produktin tek palët e treta, kjo do të bënte që njësia ekonomike C të supozonte kërkesën, inventarin dhe rreziqet e kredisë. Në këtë skenar, një ndryshim i tillë në faktet dhe rrethanat do të kërkonte rivlerësimin e klasifikimit të marrëveshjes së përbashkët. Faktet dhe rrethanat e tilla do të tregonin se marrëveshja është një sipërmarrje e përbashkët.

B33 Diagrami i mëposhtëm pasqyron vlerësimin që një njësi ekonomike ndjek për të klasifikuar një marrëveshje, kur marrëveshja e përbashkët është e strukturuar përmes një mjeti të veçantë:

A kushtet e marrëveshjes kontraktuale të specifikojë se partitë kanë të drejta ndaj pasurive, dhe detyrimet për detyrimet, në lidhje me marrëveshjen e

Klasifikimi i një marrëveshje të përbashkët e strukturuar përmes një mjeti të veçantë



Pasqyrat financiare të palëve në një marrëveshje të përbashkët (paragrafi 22)

Kontabiliteti për shitjet ose kontributet në aktive në një operacion të përbashkët

- B34 Kur një njësi ekonomike hyn në një transaksion, të tillë si një shitje ose kontribut në aktive, me një operacion të përbashkët, në të cilin ajo është një operator i përbashkët, në këtë rast është duke e kryer transaksionin me palët e tjera të operacionit të përbashkët dhe, si i tillë, ky operator i përbashkët do të njohë fitime dhe humbje që rrjedhin nga një transaksion vetëm deri në masën e interesave të palëve të tjera në operacionin e përbashkët.
- B35 Kur transaksione të tilla sigurojnë evidencë të një zvogëlimi të vlerës neto të realizueshme të aktiveve, të shitura ose që janë dhënë në formë kontributi te operacioni i përbashkët, ose të një humbjeje nga zhvlerësimi të këtyre aktiveve, këto humbje do të njihen plotësisht nga operatori i përbashkët.

Kontabiliteti për blerjet e aktiveve nga një operacion të përbashkët

- B36 Kur një njësi ekonomike hyn në një transaksion, i tillë si një blerje e aktiveve, me një operacion të përbashkët, në të cilën ajo është një operator i përbashkët, njësia ekonomike nuk do të njohë pjesën e saj të fitimeve dhe humbjeve derisa të rishesë këto aktive tek një pale e tretë.
- B37 Kur transaksione të tilla sigurojnë evidencë të një uljeje në vlerën neto të realizueshme të aktiveve të blera apo të një humbjeje nga zhvlerësimi i këtyre aktiveve, një operator i përbashkët do të njohë pjesën e tij në këto humbje.

Shtojca C

Data e hyrjes në fuqi, periudha tranzitore dhe shfuqizimi i SNRF-ve të tjera

Kjo shtojcë është pjesë integrale e SNRF-së dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të SNRF-së.

Data e hyrjes në fuqi

- C1 Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë SNRF për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2013 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë SNRF për një periudhë më të hershme, ajodo të japë informacione shpjeguese për këtë fakt dhe në të njëjtën kohë do të zbatojë SNRF 10, SNRF 12 *Dhënia e informacioneve shpjeguese për interesat në njësitë e tjera ekonomike*, SNK 27 (i ndryshuar në 2011) dhe SNK 28 (i ndryshuar në 2011).

Periudha tranzitore

Sipërmarrjet e përbashkëta-kalimi nga konsolidimi proporcional në metodën e kapitalit neto

- C2 Kur bëhet ndryshimi nga metoda e konsolidimit proporcional në atë të kapitalit neto, njësia ekonomike do të njohë investimet e saj në sipërmarrjen e përbashkët qysh në fillimin e periudhës më të hershme të paraqitur. Ky investim fillestar do të jetë sa totali i vlerës kontabël të aktiveve dhe pasiveve që njësia ekonomike i kishte konsoliduar më parë, në mënyrë proporcionale, duke përfshirë çdo emër të mirë që rrjedh nga blerja. Në qoftë se emri i mirë i përkiste më parë një njësie gjeneruese mjeteve monetare më të madhe ose një grupi njësisish gjeneruese të mjeteve monetare, njësia ekonomike do ta shpërndajë emrin e mirë tek sipërmarrja e përbashkët në bazë të vlerave kontabël përkatëse të sipërmarrjes dhe të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare ose grupit të njësisive gjeneruese të mjeteve monetare.
- C3 Teprica e çeljes e investimeve, e përcaktuar në përputhje me paragrafin C2, konsiderohet si kosto e supozuar e investimit në njohjen fillestare. Një njësi ekonomike do të zbatojë paragrafët 40-43 të SNK 28 (i ndryshuar në 2011) për tepricën e çeljes së investimeve që të vlerësojë nëse investimi është i zhvlerësuar dhe do të njohë çdo humbje nga zhvlerësimi si një rregullim në fitimet e pashpërndara në fillimin e periudhës më të hershme të paraqitur. Përjashtimi nga njohja fillestare, në paragrafët 15 dhe 24 të SNK 12 *Tatimet mbi të ardhurat*, nuk zbatohet kur njësia ekonomike njih një investim në një sipërmarrje të përbashkët, që rrjedh nga zbatimi i kërkesave të tranzicionit për

sipërmarrjet e përbashkëta, të konsoliduara më parë në mënyrë proporcionale.

- C4 Nëse nga totalizimi i të gjitha aktiveve dhe i detyrimeve, të konsoliduara më parë në mënyrë proporcionale, do të ketë një rezultat negativ të aktiveve neto, një njësi ekonomike do të vlerësojë nëse ka detyrime ligjore ose konstruktive në lidhje me aktivet neto negative, dhe nëse është kështu, njësi ekonomike do të njohë pasivin përkatës. Nëse njësi ekonomike arrin në përfundimin se nuk ka detyrime ligjore ose konstruktive në lidhje me aktivet neto negative, ajo nuk do të njohë pasivin përkatës, por do të rregullojë fitimet e pashpërndara në fillim të periudhës më të hershme të paraqitur. Njësi ekonomike do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt, së bashku me pjesën e vet kumulative, të panjohur, të humbjeve të sipërmarrjes së përbashkët si në fillim të periudhës më të hershme të paraqitur, dhe në datën në të cilën ky SNRF zbatohet për herë të parë.
- C5 Një njësi ekonomike jep informacion shpjegues për përbërjen analitike të aktiveve dhe detyrimeve që janë totalizuar në tepicën e vetme të zërit investim që nga fillimi i periudhës më të hershme të paraqitur. Ky informacion shpjegues do të përgatitet në mënyrë të përmbledhur, për të gjitha sipërmarrjet e përbashkëta, për të cilat një njësi ekonomike zbaton kërkesat e tranzicionit, të përmendura në paragrafët C2–C6.
- C6 Pas njohjes fillestare, një njësi ekonomike do të kontabilizojë investimin e saj në sipërmarrjen e përbashkët duke përdorur metodën e kapitalit neto, në përputhje me SNK 28 (i ndryshuar në 2011).

Operacionet e përbashkëta-kalimi nga metoda e kapitalit neto në kontabilitetin për aktivet dhe pasivet

- C7 Kur kalon nga metoda e kapitalit neto në kontabilitetin për aktivet dhe pasivet, në lidhje me interesin në një operacion të përbashkët, një njësi ekonomike, në fillim të periudhës më të hershme të paraqitur, do të çregjistrojë investimin, që është kontabilizuar më parë duke përdorur metodën e kapitalit neto dhe çdo zë tjetër që ka qenë pjesë e investimit neto të njësisë ekonomike në marrëveshje, në përputhje me paragrafin 38 të SNK 28 (i ndryshuar në 2011), dhe do të njohë pjesën që ka tek çdo aktiv dhe pasiv, në lidhje me interesin e saj në operacionin e përbashkët, duke përfshirë çdo emër të mirë, që mund të ketë qenë pjesë e vlerës kontabël neto të investimit.
- C8 Një njësi ekonomike do të përcaktojë interesin e saj në aktivet dhe pasivet, që lidhen me operacionin e përbashkët, në bazë të të drejtave dhe detyrimeve të saj, në një raport të përcaktuar, në përputhje me marrëveshjen kontraktuale. Një njësi ekonomike mat vlerat fillestare kontabël të aktiveve dhe pasiveve duke i veçuar ato nga vlera kontabël e investimit, në fillim të periudhës më të hershme të paraqitur, në bazë të informacionit të përdorur nga njësi ekonomike në zbatimin e metodës së kapitalit neto.

- C9 Çdo diferencë që rrjedh nga investimi, i kontabilizuar më parë duke përdorur metodën e kapitalit neto, së bashku me të gjitha zërat e tjerë, që janë pjesë e investimit neto të njësisë ekonomike në marrëveshje, në përputhje me paragrafin 38 të SNK 28 (i ndryshuar në 2011), dhe shumës neto të aktiveve dhe pasiveve, duke përfshirë çdo emër të mirë, të njohur, do të:
- (a) kompensohet kundrejt emrit të mirë në lidhje me investimet dhe çdo diferencë e mbetur rregullohet kundrejt fitimeve të pashpërndara, në fillim të periudhës më të hershme të paraqitur, në qoftë se shuma neto e aktiveve dhe pasiveve, duke përfshirë çdo emër të mirë, të njohur, është më e lartë se investimi (dhe çdo zë tjetër që është pjesë e investimit neto të njësisë ekonomike) i çregjistruar.
 - (b) rregullohet kundrejt fitimeve të pashpërndara në fillim të periudhës më të hershme të paraqitur, në qoftë se shuma neto e aktiveve dhe pasiveve, duke përfshirë çdo emër të mirë, të njohur, është më e ulët se investimi (dhe çdo zë tjetër që është pjesë e investimit neto të njësisë ekonomike) i çregjistruar.
- C10 Një njësi ekonomike, kur bën kalimin nga metoda e kapitalit neto në kontabilitetin për aktivet dhe pasivet, do të bëjë një rakordim midis investimit të çregjistruar, dhe aktiveve dhe pasiveve të njohura, së bashku me çdo diferencë të mbetur, të rregulluar kundrejt fitimeve të pashpërndara, në fillim të periudhës së hershme të paraqitur.
- C11 Përjashtimi nga njohja fillestare, në paragrafët 15 dhe 24 të SNK 12, nuk zbatohet kur njësi ekonomike njuh aktivet dhe pasivet në lidhje me interesin e saj në një operacion të përbashkët.

Dispozitat e periudhës tranzitore për pasqyrat financiare individuale të një njësie ekonomike

- C12 Një njësi ekonomike që e ka kontabilizuar më parë interesin e saj në një operacion të përbashkët, në përputhje me paragrafin 10 të SNK 27, në pasqyrat e saj financiare individuale, si një investim me kosto ose në përputhje me SNRF 9, do të:
- (a) çregjistrojë investimin dhe do të njohë aktivet dhe pasivet, në lidhje me interesin e saj në operacionin e përbashkët, me shumën e përcaktuara në përputhje me paragrafët C7–C9.
 - (b) bëjë një rakordim midis investimit të çregjistruar, dhe aktiveve dhe pasiveve të njohura, së bashku me ndonjë diferencë të mbetur, rregulluar në fitimet e pashpërndara, në fillim të periudhës së hershme të paraqitur.
- C13 Përjashtimi nga njohja fillestare, në paragrafët 15 dhe 24 të SNK 12, nuk zbatohet, kur njësi ekonomike njuh aktivet dhe pasivet, që lidhen me interesin e saj në një operacion të përbashkët, në pasqyrat e saj financiare

individuale, si rezultat i zbatimit të kërkesave tranzitore për operacionet e përbashkëta, të përmendura në paragrafin C12.

Referencat në SNRF 9

- C14 Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë SNRF, por ende nuk zbaton SNRF 9, çdo referencë në SNRF 9 do të lexohet si një referencë ndaj SNK 39 *Instrumentet financiarë: Njohja dhe matja*.

Shfuqizimi i SNRF-ve të tjera

- C15 Ky standard zëvendëson SNRF-të e mëposhtme:
- (a) SNK 31 *Interesat në sipërmarrjet e përbashkëta*; dhe
 - (b) SIC-13 *Njësi të bashkëkontrolluara—Kontributet në formë jomonetare nga sipërmarrësit*

Shtojca D

Ndryshimet në SNRF-të e tjera

Kjo shtojcë paraqet ndryshimet në SNRF-të e tjera, që janë pasojë e nxjerrjes së SNRF 11 nga Bordi. Një njësi ekonomike do të zbatojë ndryshimet për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2013 e në vijim. Nëse një njësi ekonomike e zbaton SNRF 11 për një periudhë më të hershme, ajo do të zbatojë ndryshimet për këtë periudhë më të hershme. Paragrafët e ndryshuar janë treguar me tekst të ri të nënvizuar, ndërsa teksti i fshirë është me një vizë që i kalon mes përmes.

D1 Kjo tabelë tregon se referencat e mëposhtme janë ndryshuar në SNRF-të e tjera.

Referenca ekzistuese në	e përfshirë në	në	është ndryshuar duke iu referuar
SNK 31 <i>Interesat në sipërmarrjet e përbashkëta</i>	SNRF 2	paragrafin 5	SNRF 11 <i>Marrëveshjet e përbashkëta</i>
	SNRF 9 (nxjerrë në tetor 2010)	paragrafët B4.3.12(c)	
	SNK 36	paragrafin 4(c)	
	KIRFN 5	Referencat	
	KIRFN 9	paragrafin 5(c)	
SNK 28 <i>Investimet në pjesëmarrje</i>	SNK 18	paragrafin 6(b)	SNK 28 <i>Investimet në pjesëmarrjet dhe sipërmarrjet e përbashkëta</i>
	SNK 36	paragrafin 4(b)	
	KIRFN 5	Referencat	
kontroll i përbashkët mbi	SNK 24	Paragrafët 9(a)(l) dhe 11(b)	kontroll i përbashkët i

njësia (njësitë) e kontrolluara bashkërisht	SNRF 1	titullin para paragrafit 31, paragrafët 31 dhe D1 (g), titulli para paragrafit D14, paragrafët D14 dhe D15	sipërmarrja (sipërmarrjet) e përbashkët
	SNK 36	titullin para paragrafit 12(h) dhe paragrafët 12(h) dhe 12(h)(ii)	
sipërmarrja (sipërmarrjet) e përbashkët	SNK 12	paragrafët 2, 15, 18(e), 24, titullin para paragrafit 38, paragrafët 38, 38(a), 44, 45, 81(f), 87 dhe 87C	marrëveshje (marrëveshjet) e përbashkët
	SNK 21	përkufizimi 'operacioni i huaj' në paragrafin 8 dhe paragrafët 11 dhe 18	
sipërmarrësi (sipërmarrësit)	SNK 24	paragrafët 11(b) dhe 19(e)	sipërmarrës (sipërmarrësi) i përbashkët

SNRF 1 Miratimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

D2 Paragrafi 39I është shtuar si më poshtë:

39I SNRF10 *Pasqyrat financiare të konsoliduara* dhe SNRF 11 *Marrëveshjet e përbashkëta*, të lëshuara në maj 2011, ndryshuan paragrafët 31, B7, C1, D1, D14 dhe D15 dhe shtuan paragrafin D3. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime, kur ajo të zbatojë SNRF 10 dhe SNRF 11.

D3 Paragrafi D1 është ndryshuar si më poshtë:

D1 Një njësi ekonomike mund të zgjedhë të përdorë një ose më shumë nga përjashtimet e mëposhtme:

(a) ...

(p) shlyerjen e pasiveve financiare me instrumente të kapitalit neto (paragrafi D25); ~~dhe~~

(q) hiperinflacion të lartë (paragrafët D26–D30)- ; dhe

(r) marrëveshjet e përbashkëta (paragrafi D31).

D4 Pas paragrafit D30, janë shtuar një titull dhe paragrafi D31.

Marrëveshjet e përbashkëta

D31 Një miratues për herë të parë mund të zbatojë dispozitat tranzitore në SNRF 11 me përjashtimin e mëposhtëm. Kur kalohet nga konsolidimi proporcional në metodën e kapitalit neto, një miratues, për herë të parë, do të testojë për zhvlerësimin e investimit në përputhje me SNK 36 që nga fillimi i periudhës së hershme të paraqitur, pavarësisht nëse ka ndonjë tregues se investimi mund të jetë i zhvlerësuar. Çdo zhvlerësim që rezulton do të njihet si një rregullim në fitimet e pashpërndara në fillim të periudhës së hershme të paraqitur.

SNRF 2 *Pagesa të bazuara në aksione*

D5 Paragrafi 63A është shtuar si më poshtë:

63A SNRF 10 *Pasqyrat financiare të konsoliduara* dhe SNRF 11, të lëshuara në maj të vitit 2011, ndryshuan paragrafin 5 dhe shtojcën A. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime, kur ajo të zbatojë SNRF 10 dhe SNRF 11.

SNRF 5 *Aktivet afatgjata të mbajtura për shitje dhe veprimtaritë e ndërprera*

D6 Paragrafi 28 është ndryshuar si më poshtë:

28 Njësia ekonomike do të përfshijë çdo rregullim, të kërkuar në vlerën kontabël të një aktivi afatgjatë material, që pushon së qeni i klasifikuar si i mbajtur për shitje, në fitimin ose humbjen [shënimi është hequr] nga veprimtaritë e vazhdueshme, në periudhën për të cilën nuk plotësohen më kriteret në paragrafët 7-9. Pasqyrat financiare, për periudhat qysh nga viti i klasifikimit si i mbajtur për shitje, do të ndryshohen në përputhje me rrethanat, nëse grupi i nxjerrë jashtë përdorimit ose aktivi afatgjatë që pushon së qeni i klasifikuar si i mbajtur për shitje, është një filial, operacion i përbashkët, sipërmarrje e përbashkët, pjesëmarrje, apo një pjesë e një interesi në një sipërmarrje të përbashkët ose pjesëmarrje. Njësia ekonomike do ta paraqesë këtë rregullim me të njëjtën nëntitull në pasqyrën e të ardhurave të përgjithshme për të paraqitur një fitim ose humbje, nëse ka, të njohur në përputhje me paragrafin 3737.

- 28 Pasqyrat financiare për periudhat që nga viti i klasifikimit si i mbajtur për shitje
- D7 Paragrafi 44G është shtuar si më poshtë:
- 44G SNRF 11 *Marrëveshjet e përbashkëta*, i publikuar në maj 2011, ka ndryshuar paragrafin 28. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim, kur ajo të zbatojë SNRF 11 11.

SNRF 7 Instrumentet financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese

- D8 Paragrafi 3(a) është ndryshuar si më poshtë:
- 3 Ky SNRF do të zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike për të gjitha llojet e instrumenteve financiare, me përjashtim të:
- (a) atyre interesave në filiale, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkëta që kontabilizohen në përputhje me SNRF 10 Pasqyrat financiare të konsoliduara, SNK 27 ~~Konsoliduara dhe Pasqyrat financiare individuale~~, ose SNK 28 *Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta* ose SNK 34 ~~Interesat në sipërmarrjet e përbashkëta~~. Megjithatë, në disa raste, SNK 27, ose SNK 28 ose SNK 34 lejon një njësi ekonomike të kontabilizojë një interes në një filial, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët duke përdorur SNK 39; në këto raste, ...
- D9 Paragrafi 44O është shtuar si më poshtë:
- 44O SNRF 10 dhe SNRF 11 *Marrëveshjet e përbashkëta*, të publikuara në maj të vitit 2011, kanë ndryshuar paragrafin 3. Një njësi ekonomike do ta zbatojë këtë ndryshim kur të zbatojë SNRF10 dhe SNRF11.

SNRF 9 Instrumentet financiare (publikuar në nëntor 2009)

- D10 Paragrafi 8.1.2 është shtuar si më poshtë:
- 8.1.2 SNRF10 *Pasqyrat financiare të konsoliduara* dhe SNRF 11 *Marrëveshjet e përbashkëta*, të lëshuara në maj 2011, kanë ndryshuar paragrafin C8 dhe hequr paragrafët C18-C23 dhe titujt përkatës. Një njësi ekonomike do ta zbatojë këto ndryshime kur të zbatojë SNRF10 dhe SNRF11.
- D11 Në Shtojcën C, në paragrafin C8, ndryshimet në paragrafin 3 (a) të SNRF 7 *Instrumentet financiarë: Dhënia e informacioneve shpjeguese* janë ndryshuar si më poshtë:

- 3 Ky SNRF do të zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike për të gjitha llojet e instrumenteve financiare, me përjashtim të:
- (a) atyre interesave në filiale, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkëta që kontabilizohen në përputhje me SNRF 10 Pasqyrat financiare të konsoliduara, SNK 27 ~~Konsoliduara dhe Pasqyrat financiare individuale~~, ose SNK 28 ~~Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta~~ ose SNK 34 ~~Interesat në sipërmarrjet e përbashkëta~~. Megjithatë, në disa raste, SNK 27, ose SNK 28 ose SNK 34 lejon një njësi ekonomike të kontabilizojë një interes në një filial, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët duke përdorur SNK 39; në këto raste, ...

D12 Titulli sipër paragrafit C20 dhe paragrafët C20 dhe C21 janë hequr.

D13 Titulli sipër paragrafit C22 dhe paragrafët C22 dhe C23 janë hequr.

SNRF 9 Instrumentet financiare (publikuar në tetor 2010)

D14 Paragrafi 7.1.2 është shtuar si më poshtë:

7.1.2 SNRF 10 dhe SNRF 11 *Marrëveshjet e përbashkëta*, të publikuara në maj 2011, kanë ndryshuar paragrafët 3.2.1, B3.2.1-B3.2.3, B4.3.12 (c), B5.7.15, C11 dhe C30 dhe janë hequr paragrafët C23-C28 dhe titujt përkatës. Një njësi ekonomike do ta zbatojë këto ndryshime kur të zbatojë SNRF10 dhe SNRF11.

D15 Në Shtojcën C, në paragrafin C11, ndryshimet në paragrafin 3 (a) të SNRF 7 *Instrumentet financiarë: Dhënia e informacioneve shpjeguese* janë ndryshuar si më poshtë:

- 3 Ky SNRF do të zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike për të gjitha llojet e instrumenteve financiare, me përjashtim të:
- (a) atyre interesave në filiale, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkëta që kontabilizohen në përputhje me SNRF 10 Pasqyrat financiare të konsoliduara, SNK 27 ~~Konsoliduara dhe Pasqyrat financiare individuale~~, ose SNK 28 ~~Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta~~ ose SNK 34 ~~Interesat në sipërmarrjet e përbashkëta~~. Megjithatë, në disa raste, SNK 27, ose SNK 28 ose SNK 34 lejon një njësi ekonomike të kontabilizojë një interes në një filial, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët duke përdorur SNRF 9; në këto raste, ...

D16 Titulli sipër paragrafit C25 dhe paragrafët C25 dhe C26 janë hequr.

D17 Titulli sipër paragrafit C27 dhe paragrafët C27 dhe C28 janë hequr.

D18 Në paragrafin C30, ndryshimet e paragrafit 4 (a) të SNK 32 *Instrumentet Financiare: Paraqitja* ndryshohen si më poshtë:

- 4 **Ky SNRF do të zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike për të gjitha llojet e instrumenteve financiare, me përjashtim të:**
- (a) **atyre interesave në filiale, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkëta që kontabilizohen në përputhje me SNRF 10 Pasqyrat financiare të konsoliduara, SNK 27 Konsoliduara dhe Pasqyrat financiare individuale, ose SNK 28 Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta ose ~~SNK 31 Interesat në sipërmarrjet e përbashkëta~~. Megjithatë, në disa raste, SNK 27, ose SNK 28 ~~ose SNK 31~~ lejon një njësi ekonomike të kontabilizojë një interes në një filial, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët duke përdorur SNRF 9; në këto raste, ...**

SNK 7 Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare

D19 [Nuk janë të zbatueshme kërkesat]

D20 Paragrafët 37 dhe 38 kanë ndryshuar si më poshtë:

- 37 Kur kontabilizon një investim në një pjesëmarrje, një sipërmarrje të përbashkët ose një filial, duke përdorur metodën e koston apo të kapitalit neto, një investitor e kufizon raportimin e tij në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare vetëm me flukset e mjeteve monetare midis tij dhe të investuarit, për shembull, me dividendët dhe paradhëniet.
- 38 Një njësi ekonomike, e cila raporton interesin e saj në një njësi ekonomike të bashkëkontrolluar (shih SNK 31 *Interesat në sipërmarrjet e përbashkëta*) duke përdorur konsolidimin proporcional, përfshin në pasqyrën e saj të konsoliduar të flukseve monetare pjesën e saj proporcionale të flukseve monetare të njësisë ekonomike të bashkëkontrolluar. Një njësi ekonomike e cila që raporton interesin e saj në një pjesëmarrje apo një sipërmarrje të përbashkët duke përdorur metodën e kapitalit neto, përfshin në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare, flukset e mjeteve monetare në lidhje me investimet e saj në njësinë ekonomike të bashkëkontrolluar pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët, dhe shpërndarjet dhe pagesat tjera ose arkëtimet midis saj dhe njësisë ekonomike të bashkëkontrolluar pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët.

D21 Paragrafi 50(b) është hequr.

D22 Paragrafi 57 është shtuar si më poshtë:

- 57 SNRF 10 dhe SNRF 11 *Marrëveshjet e përbashkëta*, të publikuara në maj të vitit 2011, kanë ndryshuar paragrafët 37, 38 dhe 42D dhe është hequr paragrafi 50(b). Një njësi ekonomike do ta zbatojë këto ndryshime kur të zbatojë SNRF10 dhe SNRF11.

SNK 12 Tatimet mbi të ardhurat

- D23 [Nuk janë të zbatueshme kërkesat]
- D24 [Nuk janë të zbatueshme kërkesat]
- D25 Paragrafi 39 është ndryshuar si më poshtë:
- 39 **Një njësi ekonomike do të njohë një pasiv tatimor të shtyrë për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme që lidhen me investimet në filiale, degë dhe pjesëmarrje, dhe interesat në marrëveshjet e sipërmarrjeve të përbashkëta, përveç deri në masën që plotësohen të dy nga kushtet e mëposhtme:**
- (a) **shoqëria mëmë, investitori, apo sipërmarrësi i përbashkët ose operatori i përbashkët është në gjendje të kontrollojë afatin e anulimit të diferencës së përkohshme; dhe**
- (b) ...
- D26 Paragrafi 43 është shtuar si më poshtë:
- 43 Marrëveshja midis palëve për një marrëveshje sipërmarrje të përbashkët zakonisht merret me ~~ndarjen shpërndarjen~~ e fitimeve dhe identifikon nëse vendimet mbi të tilla çështje kërkojnë pëlqimin e të gjitha sipërmarrësve palëve ose një grup të caktuar të shumicës së sipërmarrësve palëve. Kur sipërmarrësi i përbashkët apo operatori i përbashkët mund të kontrollojë afatin e shpërndarjes së pjesës së tij të ndarjes të fitimeve të marrëveshjes së përbashkët dhe është e mundur që pjesa e tij e fitimeve nuk do të shpërndahet në të ardhmen e parashikueshme, nuk njihet një pasiv tatimor i shtyrë.
- D27 Paragrafi 98A është shtuar si më poshtë:
- 98A SNRF 10 dhe SNRF 11 *Marrëveshjet e përbashkëta*, të publikuara në maj të vitit 2011, kanë ndryshuar paragrafët 37, 38 dhe 42D dhe është hequr paragrafi 50(b). Një njësi ekonomike do ta zbatojë këtë ndryshim kur të zbatojë SNRF10 dhe SNRF11.

SNK 18 Të ardhurat

- D28 [Nuk janë të zbatueshme kërkesat]

- D29 Paragrafi 41 është shtuar si më poshtë:
- 41 SNRF 11 *Marrëveshjet e përbashkëta*, i publikuar në maj të vitit 2011, ka ndryshuar paragrafin 6(b). Një njësi ekonomike do ta zbatojë këtë ndryshim kur të zbatojë SNRF1111.

SNK 21 Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit të monedhave të huaja

- D30 [Nuk janë të zbatueshme kërkesat]
- D31 Në paragrafët 3 (b) dhe 44 'konsolidimi proporcional' dhe në paragrafin 33 'konsoliduar proporcionalisht' janë fshirë.
- D32 Në paragrafin 45, 'SNK 31 *Interesat në sipërmarrjet e përbashkëta*' është hequr.
- D33 Në paragrafin 46 fjalia e fundit është ndryshuar si më poshtë:
- 46 ... Mënyrë e njëjtë përdoret për të zbatuar metodën e kapitalit neto në pjesëmarrjet dhe sipërmarrjet e përbashkëta ~~dhe në zbatimin e konsolidimit proporcional në sipërmarrjet e përbashkëta~~, në përputhje me SNK 28 *Investimet në pjesëmarrje* dhe SNK 34 (i ndryshuar në vitin 2011).
- D34 Paragrafi 48A është shtuar si më poshtë:
- 48A Përveç heqjes dorë nga i tërë interesi i një njësie ekonomike në një operacion të huaj, heqjet e pjesshme të mëposhtme trajtohen si shitje ~~edhe nëse njësi ekonomike ruan një interes në ish-filialin, pjesëmarrjen ose njësinë e bashkëkontrolluar:~~
- kur heqja dorë e pjesshme përfshin humbjen e kontrollit mbi një filial, që përfshin një operacion të huaj, pavarësisht nëse njësi ekonomike ruan një interes të pakicës në ish-filialin e saj pas shitjes së pjesshme; dhe
 - kur interesi i ruajtur pas heqjes dorë në mënyrë të pjesshme nga një interes në humbjen e influencës së konsiderueshme mbi një marrëveshje të përbashkët ose heqjes dorë në mënyrë të pjesshme nga një interes në një pjesëmarrje që përfshin një operacion të huaj është një aktiv financiar që përfshin një operacion të huaj; ~~dhe~~
 - ~~humbja e kontrollit të përbashkët mbi një njësi ekonomike të bashkëkontrolluar që përfshin një operacion të huaj.~~
- D35 Paragrafi 60F është shtuar si më poshtë:
- 60F SNRF 10 dhe SNRF 11 *Marrëveshjet e përbashkëta*, të publikuara në maj të vitit 2011, kanë ndryshuar paragrafët 3(b), 8, 11, 18, 19, 33,

44–46 dhe 48A. Një njësi ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime kur të zbatojë SNRF10 dhe SNRF 11.

SNK 24 Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura

- D36 Paragrafi 3 është shtuar si më poshtë:
- 3 **Ky Standard kërkon dhënien e informacioneve shpjeguese të transaksioneve me palët e lidhura, transaksioneve dhe tepricave të papaguara, përfshirë angazhimet, në pasqyrat financiare të konsoliduara dhe individuale të një shoqërie mëmë, sipërmarrësi ose investuesve me kontroll të përbashkët ose influencë të konsiderueshme mbi të investuarin të paraqitura në përputhje me SNRF 10 Pasqyrat financiare të konsoliduara ose SNK 27 Pasqyrat financiare të konsoliduara dhe individuale. Ky Standard zbatohet edhe për pasqyrat financiare individuale.**
- D37 Paragrafi 19 është shtuar si më poshtë:
- 19 **Dhënia e informacioneve shpjeguese, të kërkuara nga paragrafi 18, do të bëhet veçmas për secilën prej kategorive të mëposhtme:**
- (a) **shoqëria mëmë;**
 - (b) **njësitë ekonomike me kontroll të përbashkët apo influencë të konsiderueshme mbi njësinë ekonomike;**
 - (c) **filialet; ...**
- D38 Paragrafi 25 është shtuar si më poshtë:
- 25 **Një njësi raportuese është e përjashtuar nga kërkesat e paragrafit 18, për dhënie të informacioneve shpjeguese në lidhje me transaksionet me palët e lidhura dhe tepricave të papaguara, përfshirë angazhimet, me:**
- (a) **një qeveri që ka kontroll ose kontroll të përbashkët, ose influencë të konsiderueshme mbi njësinë raportuese; dhe**
 - (b) **një tjetër njësi ekonomike që është një palë e lidhur, sepse e njëjta qeveri ka kontroll ose kontroll të përbashkët, ose influencë të konsiderueshme njëkohësisht mbi njësinë raportuese dhe njësinë tjetër.**
- D39 Paragrafi 28A është shtuar si më poshtë:

- 28A SNRF 10, SNRF 11 *Marrëveshjet e përbashkëta* dhe SNRF 12, të publikuara në maj të vitit 2011, kanë ndryshuar paragrafët 3, 9, 11(b), 15, 19(b) dhe (e) dhe 25. Një njësi ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime kur të zbatojë SNRF10, SNRF 11 dhe SNRF 12.

SNK 32 Instrumentet financiare: Paraqitja

- D40 Paragrafi 4(a) është shtuar si më poshtë:
- 4 **Ky SNRF do të zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike për të gjitha llojet e instrumenteve financiare, me përjashtim të:**
- (a) **atyre interesave në filiale, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkëta që kontabilizohen në përputhje me SNRF 10 Pasqyrat financiare të konsoliduara, SNK 27 Konsoliduara dhe Pasqyrat financiare individuale, ose SNK 28 Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta ose ~~SNK 31 Interesat në sipërmarrjet e përbashkëta~~. Megjithatë, në disa raste, SNK 27, ose SNK 28 ~~ose SNK 31~~ lejon një njësi ekonomike të kontabilizojë një interes në një filial, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët duke përdorur SNK 39; ...**
- D41 Paragrafi 97I është shtuar si më poshtë:
- 97I Si rezultat i SNRF 10 dhe SNRF 11 *Marrëveshjet e përbashkëta*, të publikuara në maj të vitit 2011, janë ndryshuar paragrafët 4(a) dhe AG29. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime, kur të zbatojë SNRF 10 dhe SNRF 11.

SNK 33 Fitimet për aksion

- D42 Paragrafët 40 dhe A41 janë ndryshuar dhe është shtuar paragrafi 74B si vijon:
- 40 Një filial, sipërmarrje e përbashkët ose pjesëmarrje mund të emetojë për palë të treta, përveç shoqërisë së mëmë, sipërmarrësit ose investitorit me kontroll të përbashkët ose influencë të konsiderueshme mbi të investuarin, aksione të zakonshme potenciale që janë të konvertueshme, qoftë në aksione të zakonshme të filialit, sipërmarrjes së përbashkët ose pjesëmarrjes, qoftë në aksione të zakonshme të shoqërisë së mëmë, apo investitorëve me kontroll të përbashkët ose influencë të konsiderueshme (njësia raportuese) mbi të investuarin, sipërmarrësit ose investitorit. Nëse këto aksione të zakonshme potenciale të filialit, sipërmarrjes së përbashkët ose pjesëmarrjes

kanë efekt pakësues në fitimet bazë për aksion të njësisë raportuese, ato përfshihen në llogaritjen e fitimeve të pakësuara për aksion.

- A11 Aksionet e zakonshme potenciale të një filiali, sipërmarrje të përbashkët ose pjesëmarrje, të konvertueshme qoftë në aksione të zakonshme të filialit, sipërmarrjes së përbashkët ose pjesëmarrjes, qoftë në aksione të zakonshme të shoqërisë mëmë, apo investitorëve me kontroll të përbashkët ose influencë të konsiderueshme (njësia raportuese) mbi të investuarin sipërmarrësit ose investitorit, përfshihen në llogaritjen e fitimeve të pakësuara për aksion si më poshtë: ...
- 74B Si rezultat i SNRF 10 dhe SNRF 11 *Marrëveshjet e përbashkëta*, të publikuara në maj të vitit 2011, janë ndryshuar paragrafët 4, 40 dhe A11. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime, kur të zbatojë SNRF 10 dhe SNRF 11.

IAS SNK 36 *Zhvlerësimi i aktiveve*

D43 Paragrafi 140H është shtuar si më poshtë:

- 140H Si rezultat i SNRF 10 dhe SNRF 11, të publikuara në maj 2011, janë ndryshuar paragrafi 4, titulli sipër paragrafit 12(h) dhe paragrafi 12(h). Një njësi ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime, kur të zbatojë SNRF 10 dhe SNRF 11.

SNK 38 *Aktivet afatgjata jomateriale*

D44 Paragrafi 3(e) është shtuar si më poshtë:

- 3 Nëse një standard tjetër përshkruan kontabilizimin për një lloj të veçantë të aktivitet afatgjatë jo-material, një njësi ekonomike zbaton atë standard në vend të këtij standardi. Për shembull, ky standard nuk zbatohet për:

- (a) ...
- (e) aktivet financiare siç përkufizohen në SNK 32. Njohja dhe matja e disa aktiveve financiare mbulohen nga SNRF 10 *Pasqyrat financiare të konsoliduara*, SNK 27 *Pasqyrat financiare të konsoliduara dhe individuale*, dhe SNK 28 *Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta* dhe SNK 34 *Interesat në sipërmarrjet e përbashkëta*.
- (f) ...

D45 Paragrafi 130F është shtuar si më poshtë:

- 130F Si rezultat i SNRF 10 dhe SNRF 11 *Marrëveshjet e përbashkëta*, të publikuara në maj të vitit 2011, është ndryshuar paragrafi 3(e). Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime, kur të zbatojë SNRF 10 dhe SNRF 11.

SNK 39 Instrumentet financiarë: Njohja dhe matja (i ndryshuar në tetor të vitit 2009)

D46 Paragrafi 2(a) është shtuar si më poshtë:

- 2 **Ky SNRF do të zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike për të gjitha llojet e instrumenteve financiare, me përjashtim të:**
- (a) **atyre interesave në filiale, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkëta që kontabilizohen në përputhje me SNRF 10 Pasqyrat financiare të konsoliduara, SNK 27 Pasqyrat financiare të konsoliduara dhe individuale, ose SNK 28 Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta dhe SNK 31 Interesat në sipërmarrjet e përbashkëta. Megjithatë, njësi ekonomike do ta zbatojë këtë standard në rastin e një interesi në një filial, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët që në përputhje me SNK 27, ose SNK 28 ose SNK 34 kontabilizohet sipas këtij standardi. ...**

D47 Paragrafët AG3 dhe AG4I(a) kanë ndryshuar si më poshtë:

AG3 Njanjëherë, një njësi ekonomike bën atë çfarë ajo e quan si një 'investim strategjik' në instrumente të kapitalit neto, të emetuara nga një njësi ekonomike tjetër, me qëllim që të krijojë ose të ruajë një marrëdhënie operative afatgjatë me njësinë ekonomike në të cilën është bërë investimi. Njësia ekonomike investitore ose sipërmarrëse e përbashkët përdor SNK 28 për të përcaktuar nëse metoda kontabël e kapitalit neto është e përshtatshme për këtë lloj investimi. Në mënyrë të ngjashme, njësi ekonomike investitore përdor SNK 31 për të përcaktuar nëse konsolidimi proporcional ose metoda e kapitalit neto është e përshtatshme për këtë lloj investimi. Nëse as metoda e kapitalit neto, as konsolidimi proporcional nuk është e përshtatshme, njësi ekonomike zbaton këtë Standard për investimin strategjik.

AG4I(a) Njësia ekonomike është një organizatë sipërmarrjeje kapitali, fond i përbashkët, njësi besimi ose njësi ekonomike e ngjashme, biznesi i të cilës është investimi në aktive financiare me synimin për të përfituar nga kthimi gjithsej i tyre, në formën e interesit ose të dividendëve dhe nga ndryshimet në vlerën e drejtë. SNK 28 dhe SNK 34 lejon që të tilla investime të përjashtohen nga objekti i tyre me kusht që të maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me këtë

Standard. Një njësi ekonomike mund të zbatojë të njëjtën politikë kontabël për investimet e tjera të administruara në bazë të kthimit gjithsej, por kjo është e pamjaftueshme që këto investime të jenë objekt i SNK 28 ose SNK-31.

- D48 Paragrafi 103P është shtuar si më poshtë:
- 103P Si rezultat i SNRF 10 dhe SNRF 11 *Marrëveshjet e përbashkëta*, të publikuara në maj të vitit 2011, janë ndryshuar paragrafët 2(a), 15, AG3, AG36-AG38 dhe AG41(a). Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime, kur të zbatojë SNRF 10 dhe SNRF 11.

KIRFN 5 Të drejtat për interesat që lindin nga fondet e nxjerrjes nga përdorimi, restaurimit dhe rehabilitimit mjedisor

- D49 Paragrafët 8 dhe 9 kanë ndryshuar si më poshtë:
- 8 Kontribuesi do të përcaktojë nëse ai ka kontroll ose kontroll të përbashkët, ose influencë të konsiderueshme mbi fondin sipas referencës në ~~SNK 27~~ SNRF10, SNRF 11 dhe SNK 28, SNK 31 dhe KIS-42. Nëse po, kontribuesi do ta kontabilizojë interesin e tij në fond në përputhje me këto standarde.
- 9 Nëse një kontribues nuk ka kontroll ose kontroll të përbashkët, ose influencë të konsiderueshme mbi fondin, atëherë ai do të njohë të drejtën që të rimbursohet nga fondi në përputhje me SNK 37. Ky rimbursim do të matet me më të voglën e:
- (a) ...
- D50 Paragrafi 14B është shtuar si më poshtë:
- 14B SNRF 10 dhe SNRF 11, të publikuara në maj të vitit 2011, kanë ndryshuar paragrafët 8 dhe 9. Një njësi ekonomike do të zbatojë këto ndryshime, kur të zbatojë SNRF 10 dhe SNRF 11.

KIRFN 9 Rivlerësimi i derivateve të përfshirë

- D51 [Nuk janë të zbatueshme kërkesat]
- D52 Paragrafi 12 është shtuar si më poshtë:
- 12 SNRF 11, i publikuar në maj të vitit 2011, ka ndryshuar paragrafin 5(c). Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim, kur të zbatojë SNRF 1111.

KIRFN 16 Mbrojtjet e një investimi neto në një operacion të kryer jashtë vendit

D53 Shënimi në fund të faqes, në paragrafin 2, është ndryshuar si më poshtë:

- * Ky do të jetë rasti për pasqyrat financiare të konsoliduara, pasqyrat financiare në të cilat investime të tilla si pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkëta kontabilizohen duke përdorur metodën e kapitalit neto, pasqyrat financiare në të cilat interesat e sipërmarrësve në sipërmarrjet e përbashkëta janë konsoliduar proporcionalisht (subjekt i ndryshimeve të propozuara në ED 9 Marrëveshjet e përbashkëta, e publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në shtator 2007) dhe pasqyrat financiare që përfshijnë një degë ose një operacion të përbashkët siç është përkufizuar në SNRF 11 Marrëveshjet e përbashkëta.